



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:190691

Datë: 27.01.2020

Numri i dokumentit: 00784999

C.nr.1021/15

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Ylber Shurdhiqi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses S. T. nga fshati M., Komuna e P., të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson B. S., avokat nga P., kundër të paditurës K. S. “S.” me seli në P., të cilën e përfaqëson L. B., për kompensim dëmi, në seancën e shqyrtimit kryesor–publik, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, të mbajtur me datën 13.01.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses S. T. nga fshati M., Komuna e P., DETYROHET e paditura K. S. “S.” me seli në P., që paditëses, në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit me datën 09.03.2015, t`ia paguaj shumat e specifikuara si më poshtë:

Dëmi jo material:

- kompensim në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, shumën prej 2,200.00 Euro.
- kompensim në emër të frikës 2,100.00 Euro.

Dëmi material:

- kompensim në emër të ndihmës dhe përkujdesit të huaj, shumën prej 100.00 Euro,
- kompensim në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 100 Euro,
- kompensim në emër të shpenzimeve të mjekimit, shumën prej 168.50 Euro.

II. DETYROHET e paditura K. e S. “S.”, në P., që paditëses për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë t`ia paguaj edhe kamatën në lartësinë prej 8% duke filluar nga data 13.01.2020, e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 909.80 Euro, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

III. REFUZOHET pjesa e kërkesëpasdisë përtej shumave nga pika një e dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë, në emër të kompensimit për dhimbjet fizike, shumën prej 1,800.00 Euro, në emër të kompensimit për frikë, shumën prej 900.00 Euro, dhe në emër të shërimit klimatik dhe fizioterapeutik shumën prej 200.00 Euro, SI E PABAZUAR.

A r s y e t i m

Paditësja në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, ka theksuar se me datën 09.03.2015, rreth orës 18:15 minuta, në rrugën Matiqan-Prishtinë, ka ndodhur aksident i komunikacionit, me ç'rast deri tek aksidenti i komunikacionit ka ardhur si rezultat i lëshimeve të drejtuesit të automjetit "A", të siguruar tek e paditura, i cili duke lëvizur në mënyrë të pakujdesshme prapa, godet këmbësoren tani paditësen S. T., të cilës i shkakton lëndime të shumta trupore. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor përfaqësuesi i paditëses ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe se baza juridike e kërkesëpadisë nuk është kontesuese por vetëm lartësia. Ka propozuar që padia dhe kërkesëpadia të aprovohet në tërësi e bazuar sipas parashtrësës për precizim, po ashtu i ka kërkuar shpenzimet siç janë: për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 Euro, taksën për padi në shumë prej 25.00 Euro, për 4 seanca të mbajtura shumë prej 540.40 Euro, për ekspertiza mjekësore shumë prej 240.00 Euro, për precizim të kërkesëpadisë shumë prej 104 Euro, gjithsejtë shumë prej 1,013.40 Euro, me kamatë prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive krejt këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit.

E paditura gjatë seancaës të shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk është kontesuese baza juridike e kërkesëpadisë mirëpo kontestuese mbetet lartësia e saj, duke i propozuar gjykatës që gjatë vendosjes të ketë parasysh kriteret e kompanive me të cilën mund të jetë orientuese për gjykatën në rastet kur kemi të bëjmë me lëndime të lehta trupore.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 13.01.2020, sipas propozimit të palëve ka administruar provat relevante dhe atë: raportin e aksidentit me numër 2015-AR-0547 i datës 09.03.2015, raporti i Qendrës Emergjente numër protokollit 8010 i datës 09.03.2015, dëftesën me numër 106557 e datës 09.03.2015, dëftesën me numër 090202 e datës 14.03.2015, kuponin fiskal me numër 600278916 e datës 11.03.2015 dhe ekspertiza mjekësore e datës 01.11.2019, e punuar nga ekspertët Dr.S. D.ortoped – traumatolog dhe Dr.Sh. H. – psikiatër.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me provat e administruara, gjykata ka gjetur se me datën 09.03.2015, rreth orës 18:15 minuta, në rrugën Matiqan - Prishtinë, ka ndodhur aksident i komunikacionit, ku deri tek ky aksidenti i komunikacionit ka ardhur si rezultat i lëshimeve të drejtuesit të automjetit "A", i cili për shkak të pakujdesisë gjatë lëvizjes prapa e godet këmbësoren tani paditësen të cilës i shkakton lëndime trupore.

Deri tek kjo gjendje faktike gjykata ka ardhur duke u mbështetur në këto prova të cilat i ka pranuar si të besueshme dhe atë: Raportin e aksidentit me numër 2015-AR-0547 i datës 09.03.2015, të cilën provë gjykata e ka pranuar si të besueshme.

Kjo gjendje e vërtetuar faktike nuk ka qenë kontestuese as në mes të palëve e rrjedhimisht as nga ana e të paditurës e cila nuk e ka kontestuar faktin se deri tek aksidenti ka ardhur si rezultat i lëshimeve të drejtuesit të automjetit "A", e i cili në momentin e shkaktimit të aksidentit automjetin e ka patur të regjistruar tek e paditura, kjo vërtetohet nga me faktin se përfaqësuesi i autorizuar i paditëses në seancën e shqyrtimit kryesor ka theksuar se nuk është kontestuese baza e kërkesëpadisë.

Gjykata vlerësoi, se mos kundërshtimi i bazës juridike të kërkesëpadisë nga ana e të paditurës, e bënë përgjegjëse të paditurën për kompensimin e dëmit paditësit, pasi që shkaktuesi i dëmit ka lidhë kontratë me të paditurën dhe në këto rrethana kompensimi bëhet mbi bazën e sigurimit të auto përgjegjësive (sigurimit të detyrueshëm për palët e treta) konform nenit 136 dhe 169 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për t'i kompensuar paditësit gjënë mbështetje në dispozitat e neni 136 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Baza e kërkesëpadisë nuk ka qenë kontestuese mirëpo kontestuese në këtë çështje juridiko – civile nga e paditura ka qenë lartësia e kërkesëpadisë së precizuar nga përfaqësuesi i paditëses. Për të vërtetuar rrethanën se paditësja ka pësuar lëndime trupore, gjykata mori për bazë, Raporti i Qendrës Emergjente me numër protokollit 8010 i datës 09.03.2015 dhe ekspertizën mjekësore të datës 01.11.2019, e punuar nga ekspertët Dr.S. D. ortoped – traumatolog dhe Dr.Sh. H. – psikiatër.

Ekspertet mjekësorë, pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezentuar në shkresat e lëndës, si dhe pas ekzaminimit drejtpërdrejtë të paditëses, kanë konstatuar se paditësja ka pësuar lëndimet trupore–ndrydhje dhe përdredhje e regjionit të qafës, ndrydhje dhe përdredhje e krahut të majtë, ndrydhje dhe hematoma e regjionit të dy nëngjunjëve, ndrydhje dhe dhimbje të regjionit të barkut – ka qenë në javën e 32 të shtatëzarisë dhe për arsye të lëndimeve të pësuar në aksident ka qenë e hospitalizuar dhe e trajtuar në klinikën e gjinekologjisë prej datës 09.03.-12.03.2015.

Natyra e lëndimeve që ka pësuar paditësja si pasojë e aksidentit, kualifikohen si lëndime të rënda trupore, pa pasoja.

Me anë të ekspertizës dhe sqarimeve të dhëna në seancën e datës 16.12.2019, nga eksperti nga lëmi i ortopedis-traumatologjisë, është konstatuar se paditësja si pasojë e lëndimeve të pësuar ka përjetuar, dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 1 (një) orë, duke marr parasysh momentin e lëndimit, natyrën e lëndimit trupor, dhënien e ndihmës së parë si dhe mënyrën e transportit deri në QKUK, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë 48 (dyzetë e tetë) orë, për shkak të dhimbjeve në regjionin e qafës, krahut, këmbëve dhe barkut, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur për 3 (tre) javë, për arsye të dhimbjeve të lartëcekura, dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët në kohëzgjatje pre 1 (një) viti, herë pas here sidomos gjatë pozitave të detyruara, si dhe ndryshimeve klimatike deri në aplikimin e terapisë kundër dhembjes.

Me anë të ekspertizës është konstatuar se paditësja, si pasojë e aksidentit të komunikacionit ka përjetuar frikë primare e cila frikë ka zgjatur 1-2 sekonda, ngase e njëjta e ka parë momentin e goditjes së veturës duke qenë në trotuar (pra ka qenë këmbësore), në këtë mënyrë ajo kishte një kohë të shkurtër psikologjike për ta soditur-përceptuar gjendjen-rastin dhe për të gjykuar-menduar se do të ndodh diçka ne pasoja. Frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur për 4 ditë, e manifestuar me ankth i gjeneralizuar, habija, frika, dhimbjet fizike dhe vuajtjet shpirtërore deri në përfundim të trajtimit të pjesëve të lënduara të trupit dhe bindjes që i ka shpëtuar fryti në Klinikën e gjinekologjisë pasi që e njëjta ka qenë shtatzënë në muajin e tetë. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm e cila ka zgjatur rreth 1 muaj, e shoqëruar me peripecitë si ndrojtja, frika, ankthi, pagjumësia sidomos natën, për arsye të frikës mos do të ketë komplikime të mëtejme të frytit të saj, për të gjitha këto kishte shqetësime, frikë dhe ankth. Dhe frikë të intensitetit të ulët e cila ka zgjatur edhe për 1 muaj, e shoqëruar nga frika, pagjumësia,

rikujtimet për ngjarjen traumatike posaçërisht kur del në rrugë, e njëjta ka qenë më e shqetësuar, nervoze.

Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka pasur, shëmtim trupor po ashtu nuk ka pasur, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshme për 3 (tre) javë dhe atë i pasur me proteina, minerale dhe vitamina, ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë ka qenë i nevojshëm për 3 (tre) javë dhe atë për kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore siq janë: ushqimi, veshëmbathja dhe higjiena si dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësor, ndërsa rehabilitimi fizioterapeutik klimatik ka qenë i nevojshëm për vitin e parë pas aksidentit në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditësh. Gjykata e ka pranuar ekspertizën mjekësore në tërësi si të besueshme, meqë e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar.

Nga të gjitha arsyet e theksuara më lart gjykata vlerëson se shumat e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi paraqesin një satisfaksion moral dhe shpagim real për të gjitha format e dëmeve të cilat i ka pësuar paditësi në aksidentin e komunikacionit, andaj bazuar në dispozitat ligjore të neneve 159, 179 dhe 183 të LMD-së, si dhe standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe praktikat e deritanishme të gjykatave të Kosovës.

Me këtë rast, gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh që kompensimi të jetë satisfaksion për paditësen, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditëses.

Pastaj, dhimbjet e pësuar fizike, intensitetin e dhimbjeve dhe kohëzgjatjen e tyre, intensitetin e frikës, kohëzgjatjen dhe si është manifestuar për paditësen, duke i marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, praktikën e mirë gjyqësore (që i referohet lartësisë së kompensimit), vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar.

Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jo material, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditëses, dhe veçanërisht gjendjen e saj pasi që paditësja ishte shtatzënë dhe atë në muajin e tetë (8) të shtatzënisë, në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore të përshkruar si më lartë, gjykata miratojë kërkesëpadinë e paditëses në vlerat e shpërblimit të dëmit si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar si shpërblim real, objektiv dhe me bindje se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e lëndimit.

Ndërsa sa i përket pjesës së aprovuar sa i përket shpenzimeve të mjekimit, gjykata ja fali besimin provave që gjenden në shkresat e lëndës dëftesave me numër 106557 e datës 09.03.2015, 090202 e datës 14.03.2015, kuponit fiskal me numër 600278916 i datës 11.03.2015, nga të cilat është vërtetuar lartësia e aprovuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlihet me dëmin jo material, gjegjësisht për dhimbjet fizike dhe frikën e përjetuar të paditësit, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë, dhe se lartësia e kërkesës për këtë lloj të dëmit është e lartë dhe në kundërshtim me provat e administruara (mendimi i ekspertëve mjekësor).

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmin material dhe atë në emër të rehabilitimit klimaterik, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që nga ana e palës paditëse gjykatës nuk iu ofruan prova të mjaftueshme me të cilat kishte për tu vërtetuar lartësia e kërkesës së pretenduar. Andaj, në mungesë të dëshmive për dëmin e pretenduar material gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pjesën e refuzuar.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 të LMD-së, dhe si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës gjykata ka caktuar datën e marrjes së aktgjykimit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve për pëpëlimin e padisë, shumën prej 104.00 Euro, për taksën gjyqësore 25.00 Euro, për ekspertizë mjekësore shumën prej 240.00 Euro, për katër seanca të mbajtura për secilën nga 135.20 Euro (sipas tarifës së Odës së Avokatëve), e në total shuma prej 909.80 Euro.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm.
C.nr.1021/15, datë 13.01.2020

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njejtit, Gjykatës së Apelit në e përmes kësaj gjykate.

Gj y q t a r i,
Ylber Shurdhiqi
Prishtinë

Numri i lëndës: 2019:190691
Datë: 27.01.2020
Numri i dokumentit: 00784999